



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 14.10.2020

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 4, DATË 28.07.2020 TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË TERRITORIT “PËR PËRCAKTIMIN E LLOJIT TË PUNIMEVE PËR
TË CILAT HARTIMI I PLANEVE TË DETAJUARA VENDORE (PDV) NUK ËSHTË
I DETYRUESHËM DHE/OSE I NEVOJSHËM T’I PARAPRIJË
LEJES PËR ZHVILLIM, NDËRTIM, APO DEKLARATËS PARAPRAKE PËR
KRYERJEN E PUNIMEVE”**

Në mbështetje të neneve 7, 9 dhe 27 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të Vendimit Nr. 4, datë 28.07.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për Përcaktimin e llojit të punimeve, për të cilat hartimi i Planeve të Detajuara Vendore (PDV) nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm t’i paraprijë lejes për zhvillim, ndërtim, apo deklaratës prapake për kryerjen e punimeve”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - Në gërmën “g”, nënpika “i” shfuqizohet.
 - Në gërmën “h”, përmbajtja e nënpikave “c” dhe “d” ndryshohet si vijon:
 - c) *“Me përjashtim të tre kushteve të zhvillimit të përcaktuara në gërmën b, kërkesa për zhvillim duhet të respektojë treguesit e tjerë të zhvillimit, sipas atyre të lejuara për njësinë strukturore të PPV-së”.*
 - d) *“Në rast se treguesit e zhvillimit të njësisë për lartësinë e objektit dhe sipërfaqen totale të ndërtimit, janë më të vogla se ato të përcaktuara në gërmën b, më sipër, atëherë prevalojnë dhe zbatohen treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore”.*




Ngarkohen Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

